



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primijsen/Prodato Received/Delivary	22.12.2022	2	viti god yegj.
Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	8379/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1049/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1049/2022 të datës 23.11.2022 të parashtruar nga ankuesja

kundër Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 22.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar Ankesa me numër A.nr.1049/2022 e datës 23.11.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 3933 i datës 09.11.2022 i Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

A r s y e t i m

Ankuesja Shpresa Bunjaku Gashi me datën 23.11.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 7346/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër vendimit me Nr.3933/2022 të datës 09.11.2022 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 25.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa kjo e fundit me datë 13.12.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokolli 7993/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7346/2022 të datës 23.11.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e letërnjoftimit; Kopja e konkursit i datës 13.10.2022 për pozitën Zyrtar për Arkiv 4 të shpallur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Rezultatet e verifikimit paraprak përmes sistemit SIMBNJ; Diploma e datës 23.09.2017 me nr.1326/17 e lëshuar nga Kolegji AAB në Prishtinë; Vendimi me Nr. 3933 i datës 09.11.2022 i Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Njerëzore; Rezultatet e verifikimit paraprak; **Vërtetimi i datës 14.09.2022** që dëshmon se ankuesja është e punësuar në Komunën e Drenasit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 19.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 20.01.2022; Çertifikatë e datës 12.09.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Çertifikatë e datës 12 dhe 13 shtator 2022; Çertifikatë e muajit janar 2005; Çertifikatë e muajit qershor 2002; Çertifikatë e datës 25.10.2001; Vendimi i datës 17.11.2022 i protokolluar me nr.3933/2 me datë 18.11.2022; Njoftim i datës 18.11.2022; Të dhënat e shpalljes së konkursit; Përgjigje në ankesë e datës 13.12.2022 me numër protokolli 7993 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 25.11.2022 me numër protokolli 7414/2022; Refuzimi i ankesës e datës 11.11.2022; Lista e aplikantëve; lista e kandidatëve të aprovuar; Lista e kandidatëve të refuzuar dhe Aplikacioni i datës 02.11.2022 me nr.ref.RN00010119.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datën 13.10.2022 ka shpallur njoftimin lidhur me hapjen e konkursit me numër të referencës RN00010119 të datës 28.10.2022 deri me datën 04.11.2022 për pozitën " Zyrtar për Arkiv 4" Lëvizje brenda Kategorisë në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja.

Si kushte të veçanta për lëvizje brenda kategorisë janë përcaktuar: *"Të jetë nëpunës civil i të njëjtës kategori për të cilën aplikon: të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fund, ndërsa si kritere të përgjithshme formale janë përcaktuar; Arsimimi i kërkuar: Diploma e studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Përvoja e punës së kërkuar. Nuk kërkohet.*

Sipas Verifikimit paraprak të Njesisë së Burimeve Njerëzore nga nëntë (9) kandidatët që kanë aplikuar ,vetëm aplikacioni i ankueses është refuzuar me Vendimin me Nr. 3933 i datës 09.11.2022 të Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e

Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për arsye se e njëjta nuk i plotëson kushtet për këtë pozitë.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin me Nr. 3933 i datës 09.11.2022 të Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datën 11.11.2022 ka parashtruar ankesë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa Njësia për Burime Njerëzore në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me vendimin Nr.3933/2022 të datës 18.11.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar me arsyetimin se e njëjta nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit siç përcaktohen në nenin 41 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se *"pika 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit"*.

Ankuesja brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar se ka plotësuar të gjitha kriteret e konkursit, duke pretenduar se edhe pse ka bashkangjitur dokumentet e kërkuara bashkë me ankesën prapë ju ka refuzuar ankesa me vendimin e datës 18.11.2022 përmes sistemit të SIMBNJ nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar nenin 38 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë i cili përcakton: paragrafi 1. *Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nënparagrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji.*

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht vendimin me Nr.3933 të datës 09.11.2022 lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankueses, Kolegji ka konstatuar se Menaxheri i Burimeve Njerëzore ka vepruar në pajtim me nenin 45 paragrafin 2, 3 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbim Civil i cili përcakton; 2. *Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ 3. Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin si dhe paragrafi 5. Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve. Pasi që ankuesja me rastin e aplikimit në konkursin me numër Ref.RN00010119 të datës 09.11.2022 në pozitën "Zyrtar për Arkiv 4" nuk ka sjellë dëshmitë ashtu siç është kërkuar në konkurs, andaj pretendimi i ankueses lidhur me atë se i është bërë padrejtësi nga ana e Burimeve Njerëzore lidhur me refuzimin e aplikacionit është i pa bazuar.*

Kolegji, gjatë Shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja nuk ka ofruar dëshmi, siç janë të përcaktuara në nenin 41 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se *"pika 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë*



disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit".

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1049/2022, datë 22/12/2022

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

